



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
KOMISIONI I APELIMIT

Nr. 1527 Prot.

Elbasan, më 10.06.2024

VENDIM

Nr. 3, Datë 10.06.2024


"PËR

SHQYRTIMIN E ANKIMIT TË PROF. DR. MAJLINDA SULEJMAN PERRIU KUNDËR
VENDIMIT TË KOMISIONIT INSTITUCIONAL TË ZGJEDHJEVE NR. 12 DATË
26.05.2024"

Në zbatim të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve, për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", aprovuar me vendimin Nr. 29, datë 28.03.2024 i Senatit Akademik të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", në datën e sotme 10.06.2024, në orën 11.00, u mbledh Komisioni i Apelimit, posaçërisht i krijuar me detyrën e shqyrtimit të çdo ankimi për vendimet e marra nga Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ). Ky

Komisioni i Apelimit është i përbërë nga:

1. Prof. as. Dr. Rezarta Tahiraj (Anëtare)
2. Ph.D cand. Armelda Teta (Anëtare)
3. Dr. Ardita Dylgjeri (Anëtare)
4. Dr. Mimoza Shkëmbi (Anëtare)
5. Dr. Zyhra Gripshi (Anëtare)



1

Kryetar i këtij komisioni është Prof. as. Dr. Rezarta Tahiraj dhe sekretar i këtij komisioni është Ph.D cand. Armelda Teta, aprovuar me Vendimin Nr. 1, datë 10.06.2024 të Komisionit të Apelimit.

Kryetari i Komisionit të Apelimit, menjëherë pas konstituimit të Komisionit të Apelimit dhe caktimit të kryetarit dhe sekretarit të tij, u vu në dijeni nga Zyra e Protokollit, se është paraqitur një ankim nga Prof. Dr. Majlinda Perriu në datë 29.05.2024, protokolluar nga kjo zyrë me nr. Protokollit 1427 datë 29.05.2024 ora 08:53, drejtuar Komisionit të Apelimit Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”.

Kryetarja e Komisionit të Apelimit, në orën 10:50 të datës së sotme, mori në dorëzim ankimin si më sipër. Pasi u njoh me përmbajtjen, me urgjencën që kërkon rasti, dhe në mënyrë të menjëhershme, njoftoi të gjithë anëtarët e Komisionit të Apelimit duke i thirrur në mbledhjen e radhës Nr. 2 në orën 11:00 të datës 10.06.2024.

Rezulton, se në orën 11:00, të gjithë anëtarët e Komisionit të Apelimit janë të pranishëm. Pas këtij verifikimi nga kryetari i Komisionit të Apelimit, dhe verbalizimit të këtij fakti nga sekretari në procesverbalin e mbledhjes, kryetari i komisionit i referon Komisionit të Apelimit ankimin e paraqitur nga Prof. Dr. Majlinda Sulejman Perriu dhe nga anëtarët: Dr. Zyhra Gripshi, Ph.D cand. Armelda Teta dhe Dr. Ardita Dylgjeri, konfirmohet se në datë 31.05.2024 janë njoftuar për një ankesë që i është adresuar Komisionit të Apelimit nga Prof. Dr. Majlinda Perriu. Po nga anëtarët e sa më sipër cituar, deklarohet se ishin në pritje të njoftimit nga kryetari i komisionit, gjithmonë në respektim të pikës 6, të Nenit 36 të afatit ligjor “brenda 5 ditëve kalendarike” për t’u shprehur me vendim të arsyetuar. Por, në datë 03.06.2024 kryetari i caktuar me vendimin Nr. 1 datë 25.05.2024 “Për konstituimin e Komisionit të Apelimit në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” dhe zgjedhjen e kryetarit dhe sekretarit të tij (akti Nr. 13/84 Protokoll datë 25.05.2024), ka paraqitur aktin e dorëheqjes së pakthyeshme nga ky komision, për arsye personale dhe familjare. Ky akt i dorëheqjes i është drejtuar Senatit Akademik dhe Rektorit të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” dhe rezulton i protokolluar me Nr. 1462 datë 03.06.2024.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe konkretisht, Vendimit Nr. 35 datë 07.06.2024 “Për disa ndryshime në vendimin e Senatit Akademik Nr. 32 datë 17.05.2024 “Për krijimin dhe përbërjen e Komisionit të Apelimit në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” (akti Nr. 1516 Protokollit datë 07.06.2024) rezulton se: Senati Akademik, në pikën 1 të vendimit të tij Nr. 32 datë 17.05.2024 “Për krijimin dhe përbërjen e Komisionit të Apelimit në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, ka bërë ndryshimet për dy anëtarë të Komisionit të Apelimit (kryetari dhe sekretari i Komisionit të Apelimit). Këto ndryshime erdhën si pasojë e dorëheqjes së njërit prej anëtarëve, në cilësinë e kryetarit, për sa shpjeguar më sipër, dhe të anëtarit të dytë në cilësinë e sekretarit.

Në këto kushte, Senati Akademik i Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", vendosi të aprovojë dy kandidatura të paraqitura me vetëkandidim për të plotësuar numrin e kërkuar nga pika 1 e Nenit 37 e Rregullores së Zgjedhjeve në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", sipas të cilit, "Komisioni i Apelimit përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë". Pas shterimit edhe të këtij argumenti sqarues, Komisioni i Apelimit merr në shqyrtim ankimin e paraqitur nga Prof. Dr. Majlinda Perriu, protokolluar nga Zyra e Protokollit të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" me Nr. 1427 Prot. datë 29.05.2024 ora 08.53, shënuar në zarfin e paraqitur nga vetë dërguesi Prof. Dr. Majlinda Perriu, adresuar Komisionit të Apelimit të Universitetit të Elbasanit. Gjithashtu, mbi zarf lexohet dhe shënimi i bërë nga kryetarja e Komisionit të Apelimit se kjo shkresë është marrë në dorëzim sot, më datë 10.06.2024 ora 10.50. Kryetari i komisionit, në prani të të gjithë anëtarëve, me unanimitet, hap zarfin që i është adresuar këtij komisioni ku rezultojnë se janë 2 fletë në numër, secila prej tyre plotësuar vetëm nga 1 faqe. Procedohet me leximin e përmbajtjes së këtyre dy shkresave si në vijim:

1. Ankim i nënshkruar nga Prof. Dr. Majlinda Sulejman Perriu që në përmbajtjen e të cilit nuk identifikohet data e nënshkrimit të këtij ankimi.
2. Fotokopje e Vendimit Nr. 314 datë 24.05.2024 "Për lirimin nga detyra e Prefektit të Qarkut të Elbasanit", Këshilli i Ministrave, i nënshkruar nga Kryeministri Edi Rama dhe Ministri i Brendshëm Taulant Balla.

Lexohet ankimi i paraqitur, nga kryetari i Komisioni i Apelimit për t'u njohur me përmbajtjen e tij të gjithë anëtarët e komisionit, dhe Komisioni konstaton se:

Objekti i ankimit është "Shfuqizimi i aktit administrativ të lartpërmendur, dhe, për rrjedhojë, regjistrimin e kandidaturës së Prof. Dr. Majlinda Sulejman Perriu dhe lënda e ankimit është "Ankim ndaj vendimit Nr. 12 datë 26.05.2024 "Për mos regjistrimin e kandidaturës për postin e autoritetit drejtues, Rektor i Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" të Prof. Dr. Majlinda Sulejman Perriu". Gjithashtu, Komisioni i Apelimit konstaton se në përmbajtjen e këtij ankimi, ankuesja evidenton si në vijim:

"Në datë 26.05.2024, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve, nëpërmjet vendimit të përcaktuar më lart ka vendosur mos regjistrimin e kandidaturës time për postin e autoritetit drejtues Rektor i Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".

Ky vendim është i padrejtë, pasi është marrë në gjykim të gabuar të fakteve dhe rrethanave ndaj, për rrjedhojë, është i pavlefshëm dhe duhet shfuqizuar."

Konkretisht, nëpërmjet VKM-së Nr. 314, datë 24.05.2024 (një kopje e VKM-së i bashkangjitet këtij ankimi), Këshilli i Ministrave ka vendosur lirimin nga detyra të Prefektit të Qarkut të Elbasanit, post, i cili mbahej nga e nënshkruara. Ky vendim ka marrë fuqi menjëherë. Ndaj, nga ajo datë, pra, 24.05.2024 nuk ekziston më asnjë pengesë ligjore për miratimin e kandidaturës sime për rolin e Rektorit në UE.

Nisur nga këto fakte, del qartë se në momentin e marrjes së vendimit të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve, nuk ka patur asnjë pengesë apo mangësi që do të çonte në refuzimin e kandidaturës.

Për sa më sipër, kërkoj

1. Pranimin e ankimit dhe shfuqizimin/ndryshimin e aktit administrativ të lartpërmendur dhe për rrjedhojë pranimin e kandidaturës time për postin e Rektorit në UE. Bashkëngjitur një kopje e VKM për lirimin nga detyra e Prefektit të Qarkut Elbasan.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin

Prof. Dr. Majlinda Sulejman Perriu

Komisioni i Apelit procedon në vazhdim me shqyrtimin e rrethanave të çështjes objekt ankimi. Nga përmbajtja e dokumentacionit të publikuar në ambientet e Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", si dhe në faqen zyrtare elektronike të tij, Komisioni i Apelit konstaton se: Me vendimin Nr. 5 datë 18.05.2024, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", ka vendosur si më poshtë:

- Të shpallë procesin e regjistrimit të kandidatëve për Rektor dhe Anëtar të Senatit Akademik të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".
- Regjistrimi i kandidatëve fillon në datë 21.05.2024 dhe përfundon në datë 25.05.2024, ora 16.00.
- Dokumentacioni për kandidim, sipas Nenit 23 të Rregullores së Zgjedhjeve të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", "Për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", dorëzohet në Komisionin Institucional të Zgjedhjeve, i cili duhet të jetë i mbyllur në një zarf.
- Ky vendim do publikohet në faqen elektronike zyrtare të UE-së dhe njësisive kryesore të UE-së.

Komisioni i Apelit, duke iu referuar dosjes së aplikimit të dorëzuar nga dërguesja Prof. Dr. Majlinda Perriu Peza dhe adresuar KIZ, Universiteti i Elbasanit "A. Xhuvani" (lexim i zarfit të dorëzuar), konstaton përmbajtjen e akteve që ndodhen brenda zarfit dhe përshkruhen si në vijim:

- Fletë aplikimi në Universitetin e Elbasanit Aleksandër Xhuvani (2 fletë).
- Kopje e noterizuar e dokumentit Diplomë për titullin "Profesor" (2 fletë).
- Kërkesë "Për shprehjen e vullnetit për kandidim për pozicion drejtues të Institucionit të Arsimit të Lartë/Rektor i Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", datë 20.05.2024 (1 fletë).
- Kërkesë "Për kandidim për pozicion drejtues të Institucionit të Arsimit të Lartë/Rektor i Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", datë 20.05.2024" (1 fletë).
- Shkresë e Rektorit të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" Nr.1192/2 Protokolli datë 17/05/2024 "Kthim përgjigje suajës datë 13.05.2024 dhe 15.05.2024 në lidhje me paisjen me vërtetim si staf akademik i jashtëm për vitin 2024" (1 fletë).

- Vërtetim nr. 592/1 Protokoli datë 20.05.2024, lëshuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan (1 fletë).
- Formular vetëdeklarimi Nr.1 (nuk ka fituar 2 mandate sipas Ligjit 9741 datë 21.05.2007 dhe të Ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" (1 fletë).
- Formular vetëdeklarimi Nr. 2 (integriteti i lartë akademik) (1 fletë).
- Formular vetëdeklarimi Nr. 3 (nuk jam i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë) (1 fletë).
- Formular vetëdeklarimi Nr. 4 (Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen) (1 fletë).
- Kopje e dokumentit të identifikimit, kartë identiteti (1 fletë).

Në vijim Komisioni i Apelit lexon Vendimin Nr. 12 datë 26.05.2024 "Për mos regjistrimin e kandidaturës për postin e autoritetit drejtues Rektor i Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" të Prof. Dr. Majlinda Sulejman Perriu" (Nr.1386 Protokoli datë 26.05.2024) të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" me të cilin ka vendosur:


1-Të mos miratojë regjistrimin e kandidaturës për postin e autoritetit drejtues Rektori i Universitetit të Elbasanit të Prof. Dr. Majlinda Sulejman Perriu.

2-Ky vendim shpallet sot në datë 26.05.2024 dhe publikohet në ambientin dhe faqen elektronike zyrtare të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nga përmbajtja e këtij akti, Komisioni i Apelit vëren se Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ) e ka marrë këtë vendim me unanimitet.

Në pjesën arsyetuese të këtij vendimi, Komisioni i Apelit vëren se: Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ) në mbledhjen e tij të datës 26.05.2024, pasi shqyrtoi aplikimin e Prof. Dr. Majlinda Perriu për postin e autoritetit drejtues Rektor i Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", konstatoi se Zj. Majlinda Sulejman Perriu aktualisht ushtron detyrën e Prefektit të Qarkut Elbasan, provuar kjo me dokumentin "Vërtetim" me nr.592/1 prot. datë 20.05.2024. Bazuar në Ligjin Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 7 pika 2 në të cilin përcaktohen shprehimisht se "Funksioni i Prefektit të Qarkut është i papajtueshëm me çdo mandat zgjedhor e me çdo funksion tjetër publik, me përjashtim të mësimdhënies me kohë të pjesshme dhe veprimtarive shkencore". Gjithashtu, Komisioni i Apelit vëren se ky vendim i Komisionit Institucional të Zgjedhjeve është i mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", "Rregulloren e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në Universitetin "Aleksandër Xhuvani" i miratuar nga Senati Akademik me Vendimin Nr.29, datë 28.03.2024.



Pas këtyre konstatimeve, Komisioni i Apelimit, gjithashtu, vëren se: Nga Prof. Dr. Majlinda Perriu, në datë 28.05.2024, është dërguar një zarf që i adresohet Komisionit Institucional Zgjedhor në UE “A.Xhuvani” dhe Komisionit të Apelimit në Universitetin e Elbasanit “A.Xhuvani”, protokolluar më 28.05.2024 me nr.1425 protokollit të zyrës së Protokollit të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, ora 16:10. Ky zarf, i marrë në dorëzim sot më 10.06.2024 ora 10:50, nga kryetarja e Komisionit të Apelimit, kqyret nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Apelimit në këtë mbledhje dhe hapet në praninë e tyre dhe rezulton kjo përmbajtje:

- Dy shkresa të lidhura me njëra -tjetrën (në total 2 fletë), ku shkresa e parë është “Ankim”, në përmbajtjen e së cilës nuk rezulton të ketë datë dhe është e nënshkruar nga Prof. Dr. Majlinda Sulejman Perriu. Shkresa e dytë është fotokopje e Vendimit Nr.314 datë 24.05.2024 “Për lirimin nga detyra të Prefektit të Qarkut të Elbsanit” i Keshillit të Ministrave, i nënshkruar nga Kryeministri dhe Ministri i Brendshëm.

Komisioni vëren se: Përmbajtja e këtyre dy shkresave është identike me përmbajtjen e dy shkresave të dorëzuara me zarfin e datës 29.05.2024 nga dërguesja Prof. Dr. Majlinda Perriu.

Pas shqyrtimit në tërësinë e saj të çështjes dhe në tërësinë e tij të dokumentacionit, Komisioni i Apelimit vendos, me unanimitet, të bëjë vlerësimin e çështjes në zbatim të detyrës së tij për të cilën është krijuar posaçërisht për shqyrtimin e çdo ankimi për vendimet e marra nga Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ).

Gjatë shqyrtimit të çështjes, Komisioni i Apelimit konstaton se:

- Afati për dorëzimin e dokumentacionit të kandidatëve filloi më 21.05.2024 dhe përfundoi më datë 25.05.2024 ora 16.00.
- Ankuesja ka paraqitur dokumentacionin për kandidim brenda afatit të përcaktuar nga Komisioni Institucional i Zgjedhjeve. Rezulton se, në këtë dokumentacion nuk gjendet i depozituar nga ankuesja VKM nr.314 datë 24.05.2024.
- Në dokumentacionin e dorëzuar, ankuesja nuk e ka përmendur faktin e egzistencës së VKM nr.314 datë 24.05.2024, por ka paraqitur dokumentin “Vërtetim” Nr.592/1 Protokollit datë 20.05.2024, lëshuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan.
- Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ) ka shqyrtuar dhe vlerësuar dokumentacionin e dorëzuar për aplikim për Rektor në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” të Prof. Dr. Majlinda Sulejman Perriu, që ankuesja personalisht me vullnetin e saj e ka dorëzuar.
- Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ) me Vendim Nr.12 datë 26.05.2024 “Për mos regjistrimin për postin e autoritetit drejtues Rektor i Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” të Prof. Dr. Majlinda Sulejman Perriu ka vendosur me unanimitet, duke iu referuar përcaktimeve në Nenin 7 të Ligjit 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” si dhe në vlerësim të normativës ligjore në fuqi në fushën e arsimit të lartë si “Ligji nr. 80/2015 datë 22.07.2015 ‘Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në

Republikën e Shqipërisë”, ‘Rregulloren e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik”.

Komisioni i Apelit vlerëson se:

- Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ) ka detyrim të shqyrtojë, vlerësojë dhe vendos vetëm në bazë të dokumentacionit të paraqitur në Vendimin nr.15 datë 18.05.2024 të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve. Me ankimin e paraqitur më datë 28 dhe 29 Maj 2024, ankuesja ngre pretendimin se “*Në momentin e marrjes së vendimit të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve nuk ka patur asnjë pengesë apo mangësi që do të çonte në refuzimin e kandidaturës*”. Por, Komisioni i Apelit konstatoi nga dokumentacioni i shqyrtuar se në dosjen e aplikimit ankuesja ka paraqitur me vullnetin e saj dokumentin “Vërtetim nr.592/1 Protokoll datë 20.05.2024” në të cilin përcaktohet shprehimisht se: “*Vërtetohet se zonja Majlinda Sulejman Perriu, është e punësuar prej datës 25.12.2021 e në vazhdim pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan, me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.693, datë 18.11.2021. E lëshojmë këtë vërtetim sipas kërkesës së të interesuarit*”.

Ky akt zyrtar është marrë në konsideratë dhe shqyrtuar nga Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ) në datë 26.05.2024. Në këto kushte, Komisioni i Apelit gjykon se është i drejtë referimi që i bën Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ) Ligjit Nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, duke u ndalur në Nenin 7 të këtij ligji.

Në analizën në tërësi të ankimit të paraqitur nga ankuesja, Komisioni i Apelit konstaton se: Ankuesja nuk e kundërshton faktin që funksioni i Prefektit të Qarkut është i papajtuashëm me çdo mandat zgjedhor dhe me çdo funksion tjetër publik, me përjashtim të mësimdhënies me kohë të pjesshme dhe veprimtarive shkencore. Pretendimi i ngritur nga ankuesja në ankimin e datës 28 dhe 29 Maj 2024 se: “*Nuk egziston më asnjë pengesë ligjore për miratimin e kandidaturës time për rolin e Rektorit në UE*” duke paraqitur fotokopje të VKM nr. 314 datë 24.05.2024, vjen në kundërshtim me faktin e provuar po nga vetë ankuesja që nuk i ka vënë në dispozicion VKM nr. 314 datë 24.05.2024, brenda afatit të caktuar, Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ).

Komisioni i Apelit vlerëson se: Ankuesja kishte kohën e mjaftueshme për të paraqitur dokumentacionin për kandidim, sikurse vlerëson se ky dokumentacion i paraqitur nga ankuesja është shprehje e vullnetit të saj dhe Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ) e ka vlerësuar këtë dokumentacion në përmbajtjen e të cilit evidentohet edhe “Vërtetimi i Prefektit të Qarkut Elbasan” Nr. 592/1 Protokollit datë 20.05.2024.

Komisioni i Apelit vlerëson se: Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ) ka përgjegjësinë të shqyrtojë dhe të vlerësojë të gjitha aktet e administruara nga vetë ai gjatë afatit kohor të vlefshmërisë së paraqitjes të kërkesave për kandidim nga çdo kandidat potencial, duke garantuar zbatimin e Vendimit nr. 5 datë 18.05.2024 të vendosur nga Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ).

Sa më sipër, Komisioni i Apelimit vlerëson ligjshmërinë e Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ), i cili rezulton se ka zbatuar afatin e përcaktuar në vendimin e tij Nr. 5 datë 18.05.2024 “Për shpalljen e procesit të rregjistrimit të kandidatëve për Rektor dhe anëtar të Senatit Akademik të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”.

Në përfundim, Komisioni i Apelimit, në bazë të normativës ligjore të sipër cituar në këtë dokument, me unanimitet,

VENDOSI:

1. Mospranimin e ankimit të Prof. Dr. Majlinda Sulejman Perriu.
2. Lënien në fuqi të Vendimit të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ) Nr.12 datë 26.05.2024 “Për mos rregjistrimin e kandidaturës për postin e autoritetit drejtues Rektor i Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” të Prof. Dr. Majlinda Sulejman Perriu.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në rrugë gjyqësore nga pala që ka interes të ligjshëm.
4. Ky vendim i Komisionit të Apelimit shpallet publikisht, nga data e sotme 10.06.2024, në ambientet e Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” dhe në faqen zyrtare elektronike të tij.

Me marrjen e këtij Vendimi, mbledhja e Komisionit të Apelimit mbyllet në orën 16:15, dhe anëtarët e Komisionit të Apelimit nënshkruajnë procesverbalin e kësaj mbledhjeje dhe vendimin përkatës.

Kryetari i Komisionit të Apelimit
Prof.as.Dr. Rezarta Tahiraj

Sekretar i Komisionit të Apelimit
Ph.D. cand Armelda Teta

Anëtar
Dr. Zyhra Gripshi

Anëtar
Dr. Ardita Dylgjeri

Anëtar
Dr. Mimoza Shkëmbi